



Datë: 19.07.2025
Numër Protokolli: 7422/2025

A.nr.1766/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1766/2025 të datës 07.10.2025, të parashtruar nga ankuesja F.H, kundër organit të punësimit: Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.1766/2025, e datës 07.10.2025, e parashtruar nga ankuesja F.H.

II. Mbetet në fuqi Akt emërimi me numër protokolli 02-110-03-27548-25 i datës 15.09.2025 në pozitën Zyrtar i Lartë Certifikues, kategoria/ klasa Profesional 1 si dhe vendimi me numër 12-110-03-28909-2025 i datës 25.09.2025 i Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, F.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), përmes e-mailit më datë 07.10.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar me datë 07.10.2025 dhe protokolluar me numër 6625/2025, kundër Përgjigjes në kërkesë të datës 16.09.2025, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën Obiliqit, lidhur klasifikimin e pozitës së saj të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.10.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa kjo e fundit më datë 15.10.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 6625/2025 të datës 07.10.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Emalin e datës 12.09.2025 Emalin e datës 16.09.2025; Kërkesën e datës 15.09.2025 drejtuar organit të punësimit; Vendimin me numër protokollit 12-110-03-28909-25 të datës 25.09.2025; Akt emërimit me numër protokollit 02-110-03-27548-25 të datës 15.09.2025; Akt emërimit të datës 01.08.2016; Certifikatën me numër 166/2016 të datës 24.09.2016 me të cilën vërtetohet se ankuesja ka përfunduar trajnimin për Certifikuese të lëshuar nga Ministria e Financave; Kërkesën e datës 13.10.2025 për përgjigje në ankesë; Përgjigjen me numër protokollit 1766/2025 të datës 16.10.2025; Vendimin me numër 12-110-03-28909-25 të datës 25.09.2025; Emalin e datës 12.09.2025; Vendimin me numër 11-556 të datës 09.08.2016; Listën e pagave për muajin 01.01.2014 deri në muajin 01.10.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pa bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se Kryetari i Komunës së Obiliqit, me datë 09.08.2016 ka marr vendimin me numër protokollit 11-556 me të cilin ankuesja e caktuar në vendin e punës Zyrtare për Sport në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sporte transferohet në mënyrë të përhershme në vendin e punës Zyrtare Certifikuese në të njëjtën kategori funksionale gradë dhe hap të pagës, e cila sipas akt emërimit të me numër 1-16 të datës 01.08.2016 i ka takuar koeficienti 7.

Si rrjedhojë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, duke u bazuar në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Klasifikimin e Vendeve të punës pozitën “Zyrtar Certifikues” e ka vendosur në kategorinë Profesional 1 ndërsa me datë 12.09.2025, ankuesen e kanë njoftuar përmes emalit zyrtar, ku me datë 15.09.2025 e njëjta ka nënshkruar, Akt emërimit për pozitën Zyrtar Certifikues, Klasa Profesional 1.

Ankuesja, me datë 15.09.2025, i është drejtuar me kërkesë Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, me pretendimet për eliminim të diskriminimit dhe trajtimit të barabartë në pagë me Zyrtarët Certifikues në nivelin qendrorë dhe lokal, komfor legjislationit dhe praktikës institucionale, gjegjësisht kërkon që të bëhet korrigjimi dhe trajtimi i barabartë me zyrtarët e tjerë të nivelit të agjencive dhe ministrive, komfor pagës, pozitës dhe përgjegjësi si zyrtarë certifikues, duke i njohur të njëjtës të drejtën e fituar në pagë me koeficient 8.18.

Ndërsa, kjo e fundit, përmes Vendimit të datës 25.09.2025, ka refuzuar kërkesën e datës 15.09.2025, të ankueses, duke e arsyetuar se pozita “Zyrtar i Lartë Certifikues” në katalogun e vendeve të punës me numër rendor 167 është cituar në klase Profesional 1, dhe se Njësia e Burimeve Njerëzore Akt emërimit me numër protokollit 02-110-03-27548-25 të datës 15.09.2025 e ka lëshuar duke u mbështetur në legjislationin në fuqi

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër Vendimit të datës 25.09.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, pretendon se e njëjta është nxjerrë përmes vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, ashtu që kërkon aprovimin në tërësi të ankesës si të bazuar, anulimin e përgjigjes së organit të punësimit, me obligimin që organi i punësimit të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që pozita e ankuses të klasifikohet me koeficient 8.18, si dhe ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca në paga nga data e nënshkrimit të akt emërimit tutje.

Në kuptim të pretendimit ankimor se pozita e Zyrtarit i Lartë Certifikues klasifikohet e nivelit të ulët drejtues, Kolegji iu referua nenit 38 paragrafi 2, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar: 2. *Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtoren/i në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtoren/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtoren/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqës/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional”, rrjedhimisht në kuptim të kësaj bazë ligjore rezulton se në kategorinë e ulët drejtuese përfshihen vetëm pozitat e udhëheqësve të divizionit dhe pozitave të barasvlershme.*

Gjegjësisht, Rregullorja (QRK) Nr.10/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil e cila ka qenë e aplikueshme nga data 23.11.2020 deri më datë 29.12.2022, ka përcaktuar se pozita e Zyrtarit Certifikues për nga paga është baras vlerësuar me kategorinë e ulët drejtues, ku në Shtojcën Nr.1/5 tek Përshtkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Ultë, thuhet: *“Pavarësisht përcaktimeve të kësaj kategorie, për qëllim të klasifikimit pozita e certifikuesit konsiderohet si pozitë ekuivalente me drejtuesin e ultë në institucionin përkatës. Detyrat dhe përgjegjësitë e certifikuesit përcaktohen me legjislacionin relevant në fuqi”,* mirëpo, me hyrjen në fuqi më datë 30.12.2022 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e cila në nenin 35 ka shfuqizuar Rregulloren (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, nuk është trajtuar fare kategorizimi në kuptim të pagës i pozitës së Zyrtarit Certifikues dhe si rrjedhojë Kolegji erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk mund të aplikohet shtojca Nr.1/5 e Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Po ashtu, edhe Rregullorja (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 28.02.2024, nuk ka përmban ndonjë dispozitë të veçantë që rregullon çështjen e klasifikimit dhe pagës së pozitës së Zyrtarit të Lartë Certifikues, mirëpo e njëjta me nenin 4 ka përcaktuar: 1. *Pozitat e punës për nëpunësit e shërbimit civil ndahen në këto kategori: 1.1. kategoria e lartë drejtuese; 1.2. kategoria e mesme drejtuese; 1.3. kategoria e ulët drejtuese; 1.4. kategoria e specialistëve; 1.5. kategoria profesionale; Ndërsa, më nenin 15 është paraparë: 1. Klasat përbërëse të kategorisë profesionale dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1, Profesional 2, Profesional 3. Ndërsa, sipas Katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil, i cili është aprovuar me Vendimin Nr.08/226 të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pozita Zyrtar i Lartë Certifikues është aprovuar në faqen 19, nr. rendor 167 dhe kod SH-0167, klasa Profesional 1, e cila sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, korrespondon me klasën e pagës GJ31, koeficienti 5.58.*

Andaj, referuar dispozitave ligjore në fuqi rrjedhë së pozita Zyrtar të Lartë Certifikues, klasifikohet si pozitë e kategorisë profesionale, klasa profesional 1, ndërsa, paga dhe komponent e saj përcaktohen në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, në fuqi nga data 05.02.2023. Rrjedhimisht, mbi këtë bazë të konstatimit rezulton së nuk ka mbështetje ligjore pretendimi ankimor që pozita e ankueses si Zyrtare Certifikuese të kategorizohet në klasën drejtues i ulët, me koeficient të pagës 8.18.

Duke qenë se ankuesja pozitën e Zyrtarit të Lartë Certifikuese, e ushtron para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, e njëjta ka realizuar pagën me koeficient 8.18 edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë po ashtu edhe pas nënshkrimit të aktit të emërimit me numër 02-110-03-27548-25 të datës 15.09.2025, andaj Njësia e Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse nuk ka bërë ndryshimin e listës së pagave, obligohet ta bëjë ndryshimin e pagës duke e ndarë pagën nga shtesa tranzitore, sipas nenit 41 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Për me tepër në ndërlidhje me konstatimin si më sipër Kolegji për vendosje të drejtë dhe meritore mori parasysh edhe përcaktimet e Gjykatës Kushtetuese sipas Aktgjykimit për rastin nr.KO79/23, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, (në fuqi më datë 01.02.2024), e më të cilin aktgjykim janë shpall të pavlefshëm paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41. Rrjedhimisht, duke qenë së e drejta e pagës, përben një nga të drejtat me themelore nga marrëdhënia e punës, Gjykata Kushtetuese bazuar në praktiken e saj të mëhershme, serish më Aktgjykimin për rastin Nr.KO79/23, ka ritheksuar së e drejta në pagë të fituar është e drejtë e pronës dhe ka të gjitha atributet e kësaj të drejtë të garantuar më kushtetutë, rrjedhimisht si e drejtë e pa tjetërsueshme, duke sqaruar përmes pikës 383 të aktgjykimit se: *Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të bëhet e barasvlershme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfituar nga shtesa tranzitore prej njëqind për qind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar*”.

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, gjegjësisht, të refuzoj e ankueses si të pa bazuar ankesën, duke e lënë në fuqi Akt emërimi me numër protokoll 02-110-03-27548-25 i datës 15.09.2025 në pozitën Zyrtar i Lartë Certifikues, kategoria/ klasa Profesional 1 si dhe vendimi me numër 12-110-03-28909-2025 i datës 25.09.2025 i Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, si dhe të refuzoj pretendimin ankimor se pozita e saj, përkatësisht “Zyrtarit të Lartë Certifikues” të kategorizohet/klasifikohet si pozitë e nivelit të ulët drejtues me koeficient të pagës 8.18, duke obliguar me këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Obiliqit, që ankueses ti njihet e drejta e pagës sipas ligjit për pagat në fuqi se bashku me shtesën tranzitore në mes të pagës me koeficient 8.18 dhe pagës me koeficient 5.58.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1766/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.H;
- Menaxheres së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.